



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

Nr. 130 Prot.

Tiranë më, 2 / 3 / 2020

**URDHËR**

**PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR AUTORITETET DHE ORGANET DREJTUESE NË AKADEMINË E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, nenin 39, nenin 131; në ligjin nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në Urdhërin Nr. 8, datë 14.01.2020 të MASR "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë"; në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatit akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike",

**URDHËROJ**

1. Fillimin e procesit zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Akademinë e Studimeve Albanologjike.
2. Fushata zgjedhore fillon në datën **09.04.2020**.
3. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Akademinë e Studimeve Albanologjike është data **08.05.2020**.
4. Studiuesit janë të lutur të aplikojnë pranë Senatit të ASA-së, për anëtar të Komisionit Institucional Zgjedhor dhe për anëtar të Komisionit të Apelit të ASA-së. Aplikimet pranohen deri në datën **4 mars 2020**.
5. Senati Akademik, në datën **5 mars 2020**, zgjedh me votim të fshehtë, anëtarët e Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ) dhe anëtarët e Komisionit të Apelit.

**REKTORI**

Akademik prof.dr. **Marenglen Verli**

